AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 6.2.2013

PËR PAJISJEN ME LEJE PËRDORIMI TË STRUKTURAVE TË NDËRTUARA ME SHKELJE TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËRPARA FILLIMIT ME EFEKTE TË PLOTA TË LIGJIT NR. 10 119, DATË 23.4.2009 "PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pajisjen me leje përdorimi të strukturave që kanë përfunduar ndërtimin në datën e fillimit me efekte të plota të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për panifikimin e territorit", të ndryshuar, pasi të kenë plotësuar dokumentacionin e përcaktuar nga ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disipinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar edhe në rastet kur:

a) aktkontrollet përfundimtare, të kryera nga autoritetet vendore të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, vërtetojnë se strukturat janë ndërtuar në shkelje të kushteve të lejeve të ndërtimit të miratuara, por nuk ndryshojnë sipërfaqet dhe volumin e miratuar në leje;

b) aktkontrollet përfundimtare, të kryera nga autoritetet vendore të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, vërtetojnë se strukturat janë ndërtuar në shkelje të kushteve të lejeve të ndërtimit të miratuara, të shoqëruara me shtesë të sipërfaqes dhe/ose volumit të miratuar në leje të strukturës.

Neni 2

1. Strukturat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 1 të këtij akti, pajisen me leje përdorimi vetëm për sipërfaqen dhe volumin e përcaktuar në lejen e ndërtimit.

2. Për strukturat e ndërtuara në kufi të pronës, të cilat kanë shkelur marrëveshjet me pronarët e pronave fqinje sa u përket distancave nga kufiri i pronës, leja e përdorimit jepet me shënimin, që, në rast të zhvillimit të pronave fqinje, distancat llogariten sipas projektit të miratuar me lejen e ndërtimit.

3. Për sipërfaqet dhe volumet shtesë të ndërtuara, subjekti aplikon sipas përcaktimeve të nenit 83 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009, të ndryshuar.

Neni 3

1. Pajisja me leje përdorimi për strukturat e përcaktuara në nenin 1 të këtij akti, bëhet pas dorëzimit nga ana e subjektit ndërtues/investitorit të dokumentacionit sipas projektit të zbatuar.

2. Strukturat do t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, të ndryshuar, sipas projektit të zbatuar.

Neni 4

Miratimi i listës së strukturave që pajisen me leje përdorimi sipas këtij akti normativ bëhet me vendim të këshillit vendor të njësisë përkatëse të pushtetit vendor.

Neni 5

Afati i aplikimit për t'u pajisur me leje përdorimi, sipas këtij akti normativ, është deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas miratimit të planeve të përgjithshme vendore të njësive të qeverisjes vendore,

sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009, të ndryshuar.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha